



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	31.12.2019
REFERENC-Ë:	112/212/2019
PËR/ZA/TO:	Publikun
CC:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM	Kushtrim Brahimaj, Menaxher i Burimeve Njerëzore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	RAPORT i realizimit të Planit të Personelit 2019

Duke mos përfshirë pozitat teknike dhe ato politike, Komuna e Gjakovës në vitin 2019 ka gjithsej **322 pozita të autorizuara** (shërbyes civil), aktualisht prej tyre 321 të karrierës dhe 1 jo të karrierës. Nga 322 pozita të autorizuara, 83 janë pozita të nivelit udhëheqës (këtu përfshihen drejtoret e shkollave dhe institucioneve tjera në varësi të komunës) 196 janë pozita të nivelit profesional dhe 43 janë pozita të nivelit administrativ.

Plani i Personelit 2019 parashikonte 38 pozita të lira për rekrutim, prej tyre 21 pozita të lira në rrethana të ndryshme dhe 17 pozita që lirohen gjatë vitit nga pensionimet.

Realizimi i Planit të Personelit 2019 është arritur rreth 71%, nga 38 pozita të planifikuara për rekrutim janë realizuar 27. Realizimi i Planit është bërë përmes 18 konkurseve për rekrutim (të hapura për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues) dhe 9 konkurseve për avancim (të hapura vetëm për nëpunësit civil ekzistues). Realizimi i Planit të Personelit 2019 në këtë përqindje ka ardhur si pasojë e vonesave të **Aprovimit** të Ligjit për Buxhet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si rrjedhojë na është pamundësuar që të procedojmë me konkurse deri në ditët e fundit të Janarit. Po ashtu Ligji numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka hyrë në fuqi me 11 shtator 2019 dhe më pas është **Pezulluar** nga Gjykata Kushtetuese! Si pasojë nga muaj Gusht nuk kemi pas mundësi të procedojmë me konkurse për shkak të paqartësisë Ligjore. Realizimi i Planit të Personelit 2019 në masën 71% është realizuar në periudhën prej 6 muajve (nga fundi i janarit deri në fund të korrikut).

Gjatë vitit 2019 vetëm **një** konkurs ka dështuar në mungesë kuorumi, përderisa nuk kemi **asnjë** konkurs të anuluar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Më poshtë i gjeni të bashkangjitura **18 konkurset** për rekrutim (të hapura për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues):

Nr.	Pozita	Njësia	Koha
1.	Zyrtar për Arsimin Parashkollor dhe Fillor	Drejtoria për Arsim	Janar
2.	Zyrtar për Statistika	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Mars
3.	Zyrtar për Kadastër	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Prill
4.	Zyrtar i Pasurisë	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Prill
5.	Zyrtar për Gjeodezi	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Prill
6.	Sekretar i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Haxhi Hoti"	Drejtoria për Arsim	Prill
7.	Kostumograf, Gardërobier dhe Rrobaqepës	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Prill
8.	Zëvendësdrejtor i Gjinnazit "Hajdar Dushi"	Drejtoria për Arsim	Prill
9.	Drejtor i SHFMU "Ukshin Miftari"	Drejtoria për Arsim	Prill
10.	Zëvendësdrejtor i SHFMU "Zekrija Rexha"	Drejtoria për Arsim	Prill
11.	Zyrtar për Taksë Komunale	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Maj
12.	Zyrtar i Prokurimit 1	Njësia e Prokurimit, Zyra e Kryetarit	Maj
13.	Zyrtar për Mirëqenie Sociale 4	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Maj
14.	Roje Pylli	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Maj
15.	Inspektor Sanitar	Drejtoria për Punë Inspektuese	Qershor
16.	Zyrtar për Arsimin Parashkollor dhe Fillor	Drejtoria për Arsim	Qershor
17.	Shtëpiak (Pallati i Kulturës "Asim Vokshi")	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Qershor
18.	Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Korrik

Më poshtë i gjeni të bashkangjitura **9 konkurset** për avancim (të hapura vetëm për nëpunësit civil ekzistues):

Nr.	Pozita	Njësia	Koha
1.	Udhëheqës i Sektorit të Ekonomisë	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Janar
2.	Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile	Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative	Janar
3.	Udhëheqës i Sektorit për Arsim	Drejtoria për Arsim	Mars

KOMUNA E GJAKOVËS

NJËSIA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Kosovë

Tel: 038 200 44070

kk.rks-gov.net/gjakove

4.	Udhëheqës i Prokurimit	Njësia e Prokurimit, Zyra e Kryetarit	Mars
5.	Analist i Lartë i Buxhetit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Qershor
6.	Udhëheqës i Sektorit të Ndërtimit	Drejtoria për Punë Inspektuese	Qershor
7.	Udhëheqës i Sektorit për Planifikim	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	Qershor
8.	Drejtor i Qendrës për Punë Sociale	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Qershor
9.	Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë	Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative	Korrik

Disa nga pozitat udhëheqëse në Komunën e Gjakovës aktualisht mbulohen me **ushtues detyre**, e gjithë kjo si pasojë pamundësisë për të proceduar me konkurse si pasojë e **Pezullimit** të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga Gjykata Kushtetuese.

Gjatë vitit 2019 vëmendje iu është kushtuar edhe **nevojave për trajnimin** e nëpunësve civil ekzistues dhe nëpunësve të rekrutuar gjatë vitit.

Në fund, iu informojmë se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore gjatë Vitit 2019 ka arritur të ngarkoj shënimet e nevojshme të secilit nëpunës të Komunës së Gjakovës në SIMBNJ për të mundësuar shfrytëzimin e **Pushimit Vjetor dhe pushimeve të tjera** përmes Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Deri me tani këto pushime janë shfrytëzuar përmes formatit fizik!

KOMUNA E GJAKOVËS

NJËSIA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Kosovë

Tel: 038 200 44070

kk.rks-gov.net/gjakove